VENDIM
Nr. 221, datë 28.3.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE "PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE TË QELQIT KRISTAL"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave teknike "Për etiketimin e produkteve të qelqit kristal", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[1] Ky projektvendim përafron Direktivën Europiane nr. 69/493/EEC "Për produktet e qelqit Kristal".